



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR _____, DATË ____/____/202__

PËR

**MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA
KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET
PUBLIKE PËR VITIN 2025, SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT
E NEVOJSHËM LIDHUR ME STANDARTETE KËRKUARA
NGA AKTET LIGJORE NË FUQI.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, Urdhërit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit me Nr. 38, datë 27.01.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së aplikimit për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit”, sipas relacionit për gatitur nga Grupi i punës ngritur me Urdhërin e kryetari të bashkisë nr. nr. 426, datë 08.11.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e hartës së përgjithshme për plazhet e lejuara në Bashkinë Durrës për sezonin veror 2025”, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara ku do të ushtrohet veprimtaria si stacion plazhi, plazhet publike për vitin 2025, si dhe elementët e nevojshëm lidhur me standartet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi, sipas dokumentacionit hartografik bashkëngjitur.

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Durrës për ndjekjen e procedurave të mëtejshme sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE
Drejtor

Alheida Rroshi

**PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT
KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT
DHE TË TERRITORIT**

Robert Dervishi

KRYETAR

Emiriana Sako

